

Ferma Pilot me ulli

Fshati Dukat Bashkia Orikum

Ferma pilot u ngrit në fshatin Dukat, Bashkia Orikum - Vlorë, në fermën e z Bashkim Habili. Parcela është në terren fushor. Toka ka pjellori të madhe dhe me përmbajtje të lartë humusi. Fidanat u dhanë nga QTTB-Vlorë kultivarit “Kalinjot”, të prodhuar me copa vegjetative, me një gjatësi 0.5-0.6 m lartësi, i pastër nga sëmundjet dhe dëmtuesit. U mbollën gjithsej 200 fidana në një sipërfaqe prej 0.5 ha. Në vazhdimësi nga ana jonë janë ndjekur të gjitha shërbimet agroteknike të zbatuara në këtë ullishte.

Gjatë vitit 2012 kjo fermë ka qenë në monitorim të vazhdueshëm nga ana e specialistëve. Shërbimet agroteknike janë realizuar në afatet e duhura dhe me cilësi të lartë. Ullishtja është mbajtur vazhdimisht e punuar si midis rreshtit ashtu edhe në rresht. Janë kryer të gjitha shërbimet agroteknike ujitje, plehrim si dhe janë marrë masa për mbrojtjen nga sëmundjet dhe dëmtuesit e ndryshëm. Është vendosur në të gjitha bimët material sintetik për mbrojtjen nga Otiorrinchusi, janë realizuar tre spërkatje me preparate me bazë bakri të shoqëruara me inskucid ndaj syrit të palloit dhe tenjës jeshile të majës. Situata fitosanitare paraqitet shumë e mirë. Duke bashkëpunuar specialist dhe fermer ka aritur që në fund të vitit të vitit 2013 gjendja e parcelës të jetë e mirë me fidanë të zhvilluar.

Treguesit që u morën gjatë studimit : Në të gjithë parcelën prej 0.5 ha u caktuan 10 bimë, diagonalisht të cilat përfaqësonin mesataren për nga zhvillimi vegjetativ të të gjithë bimëve të mbjella.

1-Përqindja e zënieve. Nga verifikimet e bëra rezulton se nga 200 bimë të mbjella janë zënë 190 bimë ose 95%

2-Rritja e volumit të kurorës si dhe rritja e diametrit të trungut.

Matjet u kryen në dy periudha në mars dhe në nëntor (për të dy vite)

Matjet u kryen në 10 bimë të përzgjedhura në të gjithë parcelën duke përfaqësuar të gjithë zhvillimin e bimëve. Nga të dhenat e mara nga specialistet rezulton se kurora ka pësuar një rritje mbi 60%



VITI 2012



VITI 2013

Detyra te lena fermerit

Të kryhen të gjitha shërbimet e nevojshme sipas një kalendari të dhënë nga ana e specialistit.

- Të monitorohet situata fitosanitare e të merren masa për spërkatjen kundër Tenjes jeshile të majës.

-Të mos përdoret herbicid në fushën e mbjellë me fidana ulliri. deri në tre vjet

-Të mos mbillen bimë perimore të familjes Solanaceae, pasi rrezikohet transmetimi i Verticiliumit të kultura e ullirit.